



Pas largimit drejt Italisë të trajnerit të kombëtares së Shqipërisë Xhani De Biasi, Presidenti i FSHF-së Armand Duka, menjëherë ka hedhur poshtë të gjitha zërat dhe thashethemet se trajneri Italian është larguar sepse nuk ka marrëveshje midis paleve për kontratën e re.

"Nuk është e vërtetë që trajneri Italian është larguar sepse nuk ka arritur një marrëveshje me Federatën për të rinovuar kontratën aktuale", u shpreh Ekskluzivisht për Albaniasoccer.com Presidenti i FSHF-së Armand Duka.

"De Biasi ka akoma kontratë dhe për disa arsye personale unë nuk kisha kohën e mjaftueshme në dispozicion dhe nuk isha në gjendje që të takohesha me trajnerin De Biasi për të përfunduar plotësisht bisedimet, për të vazhduar "Misteri" drejtimin e skuadër kombëtare deri në përfundim të eliminatoreve Euro 2016", theksoi Duka.

"Ne kemi një ofertë për De Biasin dhe brenda dy ditëve do të dergojmë një kopje të kontratës paraprake në adresë të tij dhe presim që gjithçka të përfundojë pozitivisht ashtu siç e kishim planifikuar edhe pse ai është larguar drejt Italisë", vazhdoi Duka prononcimin e tij për Albaniasoccer.com

Ndonëse FSHF-ja ka qenë në një situatë të tillë edhe përpara rinovimit me Hans Peter Briegel, kur të dyja palët kishin rënë dakort paraprakisht dhe kur Briegel u prezantua me kontratën e re ai nuk ra dakort pasi ishin bërë ndryshime në ato që ishin para aprovuar në marrëveshje, pritet që e njëjta situatë të mos ndodhi me Italianin i cili është optimist se do të nëshkruajë me Shqipërinë